



Ftesë për pjesëmarrje në
Konferencën Rajonale për financimin e eko-novacioneve në Evropën Juglindore
27 Prill 2009, Zagreb (Kroaci)

- A jeni të interesuar për burime financimi për eko-inovacionet dhe eko-?
- A jeni të interesuar për të investuar në projekte eko-teknologjike në vendet e EJT1?
- A jeni të interesuar për të mesuar rreth kuadrit ligjor ekzistues dhe mundësive të pritshme?

Qendra Rajonale e Mjedisit (REC), në kuadër të programeve të saj në mbështetje të aktorëve dhe sektorëve të ndryshëm në dobi të zhvillimit të qëndrueshëm organizon **Konferencën Rajonale për Financimin e Eko-inovacioneve në Evropën Juglindore**. Kjo konferencë do të mbahet ditën e Hënë, datë 27 Prill 2009, në Zagreb, Kroaci.

Qëllimi i kësaj konference është gjetja e zgjidhjeve dhe e programeve më të mira për të financuar eko-inovacionet në nivel kombëtar dhe rajonal, njohja e investitorëve dhe donatorëve kombëtarë e ndërkombëtarë me nxitësit e projekteve eko-teknologjike nga sektori privat dhe ai publik, me qëllim diskutimin e ndërsjellë të kushteve të granteve dhe huave nga njëra anë dhe nevojave e kapaciteteve të proponentëve të projektit nga ana tjetër.

Konferenca do të adresojë çështje të energjisë së qëndrueshme, riciklimit dhe prodhimit të pastër, me fokus sektorin e energjisë së qëndrueshme, i identifikuar si sektori më aktivisht i financuar gjatë periudhës aktuale. Komercializimi dhe përdorimi i teknologjive mjedisore kërkon një sërë instrumentesh financiarë. Ato variojnë nga huat klasike deri te mekanizmat e garancisë për kapitalin.

Projekti i Qendrës Rajonale të Mjedisit (REC), i titulluar "Promovimi i Mekanizmave Financiarë për Eko-inovacionet në Evropën Juglindore" synon të identifikojë dhe të vlerësojë mekanizmat ekzistues për të mbështetur dhe financuar eko-novacionet (kërkime, zhvillim dhe përdorim të eko-teknologjive) në rajonin e Evropës Juglindore. Ai konsiston në grumbullimin dhe analizimin e informacionit mbi mekanizmat ekzistues për të nxitur dhe financuar eko-novacionet në vendet e zgjedhura të Evropës Juglindore (Shqipëri, Bosnje-Hercegovinë, Kroaci, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi dhe Serbi), që do të përdoren për krijimin e një studimi krahasimor me rezultatet e rekomanduara për përmirësimin e kushteve financiare në këtë sektor. Të dhënat e draft-studimit do të prezantohen në konferencën rajonale dhe do të diskutohen me folësit dhe pjesëmarrësit me qëllim rekomandimin e mënyrave më efektive të financimit të eko-novacioneve dhe përdorimit më të gjerë të eko-teknologjive. Studimi përfundimtar me rekomandimet dhe adresari i të gjithë aktorëve të përfshirë në rajon do t'u shpërndahet pjesëmarrësve të konferencës me CD.

Konferenca do të adresojë çështjet kryesore, si:

- Si të përfshihen fondet publike dhe private?
- Si të mbushet boshllëku mes inovacionit në fazën fillestare dhe komercializimit?
- Si të krijohen stimuj fiskalë dhe të nxiten instrumentet e bashkëpunimit publik-privat?
- Si të forcohet bashkëpunimi midis agjencive përkatëse?

Folësit në konferencë janë përfaqësues nga programet e Bashkimit Evropian dhe Shteteve anëtare për mbështetjen e eko-novacioneve, programeve përkatëse rajonale të organizmave financiarë ndërkombëtarë, si dhe përfaqësues të institucioneve kombëtare, të mekanizmave financiarë, studiues dhe biznesmenë. Pjesëmarrja në konferencë do të japë mundësi për të njohur më shumë kushtet aktuale dhe mundësitë për investime në eko-novacionet dhe eko-teknologjitë në vendet e Evropës Juglindore.

Konferenca do të zhvillohet te Hotel "Dubrovnik", Gajeva 1 (afër Sheshit Bana Jelacica) në Zagreb, në 27 Prill 2009, duke filluar prej orës 8.30. Ajo do të mbahet në anglisht, me përkthim simultan në gjuhët e vendeve pjesëmarrëse. Nëse dëshironi të merrni pjesë, jeni të lutur të plotësoni formën e regjistrimit dhe ta dërgoni në rec@avrion.hr.

¹ * Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kroaci, IRJ Maqedonisë, Mali i Zi dhe Serbi